



## Universiteti i Prizrenit

<b>PROGRAMI MËSIMOR – SYLLABUS</b>							
<b>Niveli i studimeve</b>	katëvjeçar	<b>Programi</b>	<b>Gjuhë dhe letërsi shqipe</b>	<b>Viti akademik</b>	2017/18		
<b>LËNDA</b>		<b>FOLKLOR DHE ETNOLOGJI</b>					
<b>Viti</b>	II	<b>Statusi i lëndës</b>	Obligative	<b>Kodi</b>		<b>ECTS kredi</b>	<b>4</b>
<b>Semestri</b>	dimëror						
<b>Javët mësimore</b>	15		Orët mësimore			Ligjërata	Ushtrime
						2	1
<b>Metodologjia e mësimit</b>	Gjatë realizimit të orës praktikohet metodologjia interaktive, duke e bërë studentit pjesëmarrës aktiv, jo vetëm në ushtrime, por edhe në ligjëratë						
<b>Konsultime</b>							
<b>Mësimdhënësi</b>	Prof.ass.dr.. Vjollca Dibra Ibrahim			e-mail	<a href="mailto:vjollca.dibra@uni-prizren.com">vjollca.dibra@uni-prizren.com</a>		
				Tel.	044 199487		
<b>Asistenti</b>				e-mail	<a href="mailto:dibravjollca@gmail.com">dibravjollca@gmail.com</a>		
				Tel.			

<b>Qëllimi studimor i lëndës</b>	<b>Përfitimet e studentit</b>
<p>- Njohuri mbi zanafillën, zhvillimin dhe periodizimin e etnologjisë</p> <p>- Njohuri mbi kushtet e zhvillimit dhe të ruajtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore, veçanërisht mbi sinkretizmin dhe mistifikimin,</p> <p>- Elaborimi i ideve rreth projekteve të punës në terrenet e arealeve të ndryshme,</p> <p>- Organizimi i anketave me pyetësorë të përgatitur dhe aftësimi për të përpiluar anketa,</p> <p>- Idetë, njohuritë dhe kriteret për sajimin e dosjeve me materiale të studentëve,</p> <p>- Krahasimi i ndikimeve reciproke në raportet: folklor</p> <p>– etnologji nëpër formacionet stilistike dhe lëvizjet kombëtare.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi i vlerave të tradites në rrafshin e trashëgimisë kulturore.</li> <li>• Njohja e rëndësisë së transformimeve kulturore,</li> <li>• Kuptimi i drejtë i kushteve për kompozimin dhe dekompozimin e jetesës së përbashkët (familja, familja e madhe, shtëpitë, kullat),</li> <li>• Aftësimi për punë të pavarur në terrene të ndryshme,</li> <li>• Kultivimi i dashurisë ndaj trajtimit të temave nga krijimtaria popullore-gojore dhe procesin e sinkretizmit,</li> <li>• Aftësimi për të hartuar skica e harta për nevojat personale të studentëve,</li> <li>• Kuptimi i rëndësisë së metodës krahasimtare brenda fushës së krahasimtares në raportin folkloretnologji.</li> </ul>

<b>Metodologjia për realizimin e temave mësimore:</b>			
Ligjëratë e shkurtër, debat, shkrim dhe lexim i eseve, punimet e seminareve dhe puna në terren për regjistrimin e materialeve			
<b>Kushtet për realizimin e temës mësimore:</b>			
Ligjëratë dhe debate në dhoma mësimi, manjetofoni me incizime të ndryshme të lëndëve veçanërisht nga eposi dhe trashëgimia kulturore, vizitë etnomuzeve në Prizren, Gjakovë dhe Prishtinë, ekskursion nëpër Rrafshin e Dukagjinit (Vështrime mbi kullat dhe rapsodët).			
<b>Mënyra e vlerësimit të studentit ( në%)</b>			
Pjesëmarrje në ligjëratë Pjesëmarrje në ushtrime Punimet e seminareve Shkrimi i eseve Vjelja dhe regjistrimi i materialeve në terren, Testimi i pjesërishtëm, Testimi përmbledhës. 1. Testi I.....1-30 pikë, 2. Vijueshmëria dhe aktivitetet gjatë ligjëratë dhe ushtrimeve 1-20 pikë, 3. Vlerësimi i fundit (testi përfundimtar).....1-50 pikë, Gjithsej: 100 pikë	<b>Vlerësimi në %</b>	<b>Nota përfundimtare</b>	
	100% - 91%	10 (dhjete)	
	90% - 81%	9 (nëntë)	
	80% - 71%	8 (tetë)	
	70% - 61%	7 (shtatë)	
	60% - 51%	6 (gjashtë)	
	50%	5 ( pesë)	
<b>Obligimet e studentit:</b>			
<b>Ligjëratë</b> 80% pjesëmarrje në ligjëratë	<b>Ushtrime</b>  80% pjesëmarrje në ligjëratë		
<b>Ngarkesa e studentit për lëndën</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/Javë</b>	<b>Gjithsej:</b>
Ligjëratë	2	15 Javë	30
Ushtrime teorike	1	15 javë	15
Seminaret	2	4 javë	8
Koha e studimit të pavarur në biblioteka	2	15 javë	30
Projektet, prezentimet,	1	2 javë	2
Detyra të shtëpisë	1	15 Javë	15
<b>Vërejtje:</b> Po qe se vlefata e 1 ECTS kredie është 25 orë, atëherë rezultoni se për ta përgatitur provimin e lëndës e Folklor dhe etnologji, studentit i duhen 125 ose 130 orë pune. Kjo del edhe kur 125 orë, pjesëtohen me 25, rezultoni se lënda ka vlefatë prej 5 kredish.	<b>Ngarkesa totale:</b>		100

Java	Ligjërata		Ushtrime	
	Tema	Orët	Tema	Orët
1.	Prezantimi i syllabusit, njohje e studentëve me detyrat, qëllimet, objektivat dhe literaturën.	2	Njohje me studentë, me vendlindjet e tyre dhe me suksesin gjatë shkollimit të mesëm.	1
2.	Folklor dhe etnologji, nocionet themelore, lënda, objekti, fillet e para dhe metodologjia e hulumtimit	2	Të lexuarit e një cikli të këngëve lirike të riteve familjare, gjetje e dokeve dhe zakoneve të lashta si mbijetoja të egërsisë, të barbarisë	1
3.	Zanafilla, zhvillimi dhe sprovat për klasifikimin e lëndës (Egërsia, barbaria dhe qytetërimet e lashta)	2	Debat: Mbijetojat e egërsisë, animizmit, barbarisë dhe transformimet në lirikën familjare (Këngët e dasmës)	1
4.	Periodizimi i zhvillimit të etnologjisë: Paleoetnologjia, Etnologjia në Antikë, në Mesjetë, gjatë Rilindjes Kombëtare, Etnologjia në vitet e Pavarësisë dhe shkenca në ditët e sotme	2	Ushtrime: Krijimi, emitimi, variantiteti, seleksionimi dhe kontinuiteti në krijimtari popullore-gojore, bashkëveprimi i elementeve, ushtrime sinkretike	1
5.	Teoritë, metodat dhe shkollat në Folklor dhe etnologji: shkolla mitologjike, shkolla psikologjike, shkolla historiografike, funksionalizmi, strukturalizmi etj	2	Debat: Shkollat në folkloristikë dhe mundësitë e inkorporimit të metodave në folkloristikës shqiptare	1
6.	Familja, fshati, bashkësia e fshatrave dhe arealet etnologjike prej Veriut deri në Jug të trojeve etnike	2	Ushtrime: Mbushje e formularëve për anketime të banorëve të areales prej nga vinë studentët.	1
7.	Doket dhe ritet e motmotit dhe procesi i sinkretizmit Tabutë, magjitë, ritet e panspermisë, fomulat dhe lëvizjet.	2	Ushtrime: Këngët lirike rituale të riteve të motmotit, shembuj nga antologjia e D. Shalës	1

8.	Doket dhe ritet në këngët e riteve familjare - paralindja, - lindja, - emërimi, - synetia, - dasma, dhe - vdekja.	2	Ushtrime: Këngët lirike rituale të riteve familja dhe kënet e dashurisë si lirikë arituale	1
9.	▣ Mbledhësit e hershëm të Folklorit dhe dukuria e mistifikimit	2	Debat: Kontributi i mbledhësve të huaj dhe i mbledhësve arbëreshë	1
10.	Epika legjendare dhe historike Shkolla historiografike	2	Leximi dhe analiza e rapsodisë "Martesa e Halilit": doket, ritet, ushqimi dhe pijet në eposin e kreshnikëve (Bukuria e Tanushës),	1
11.	Gërshetimet epiko-lirike Doket dhe ritet si mbijetoja në këngët epiko-lirike	2	Analizë e baladës "Trim mbi trima Gjergj Elez Alia", Poetika e baladës, Struktura dhe kompozicioni	1
12.	Proza popullore; Zanafilla, zhvillimii dhe llojet e prozës popullore (auditori, narratori dhe rituali i rrëfimit rreth votrës)	2	Leximi dhe analiza e një përralle me elemente mitike e fantastike: "Cicirihja"	1
13.	Format e dendura (Format e thjeshta të krijimtarisë popullore-gojore)	2	Komentimi i urimeve, mallkimeve, betimeve, Dollive, frazeologjizmave dhe sentencave	1
14.	Teatrologjia popullore Lëvizjet, gjestet dhe ritet	2	Diskutim rreth vajtimeve, gjëmave dhe elegjive, mënyrat e vajtimit dhe tipologjia	1
15.	Udhëzimet për përgatitjen e provimin në lëndën e Folklor dhe etnologji.	2	Testet provuese: të pjesërishme dhe përmbledhëse	1

## LITERATURA

1. Mark Tirta, Etnologjia e përgjithshme, Tiranë, 2001.
2. Mark Tirta, Etnologjia shqiptarëve, Tiranë, 2003.
3. Mark Krasniqi, Nga gurra e traditës, Prishtinë, 1999.
4. Drita Statovci, Kërkime etnograafike, Prishtinë, 1988.
5. Nexhat Çoçaj, Hasi, Enciklopedi e etnokulturore, Durrës, 2012.

## VËREJTJE

Studentët janë të lirë edhe në përzgjedhjet e shkrimeve të tjera dhe studimeve rreth çështjeve nga fusha e folkloristikës dhe etnologjisë shqiptare e botërore. Veçanërisht mund të fokusohen mbi tekstet që për qasje kanë doket, zakonet dhe ritet e popujve të ndryshëm.

Pasi që studentët vinë prej fshatrave të ndryshme të Anadrinit, të Vërrinit, të Llapushës, të Opojës e të Hasit, preferohet që të vjelin materiale në vendlindjet e tyre dhe prej tyre të formojnë dosje materialesh nga terrenet e përmendura në mënyrë që më vonë, gjatë studimeve në master të kenë së pakut një koleksion me lloje e nënloje të krijimtarisë popullore-gojore dhe rite në kuadër të proceseve të mistifikimit dhe të sinkretizmit.

## Vërejtje për studentin:

Studentët duhet t'u përbahen rregullave të përcaktuara sipas Statutit të UPZ-së dhe rregulloreve dhe vendimeve të miratuara nga Senati i UPZ-së dhe këshilli mësimor

Pritet që secili student të vijë me kohë.

Nga çdo student pritet që të marrë pjesë në çdo ligjeratë. Për shkak të natyrës dhe mënyrës së mësimin në këtë lëndë, ardhja në mësim dhe pjesëmarrja aktive në diskutim është kyçe. Çdo mungesë e vazhdueshme rezulton me zbritjen e notës finale. Studentët janë të obliguar të kenë sjellje të mirë dhe të mbajnë qetësi, si dhe t'i shkyçin telefonat mobilë gjatë ligjëratave.